



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 242 Akti

Nr. 365 Vendimi
Tiranë, më 14.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 14.4.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gramoz Levanaj**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr.78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, është shortuar si subjekt rivlerësimi në shortin e hedhur në datën 15.1.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”. Nga procedura e shortit rezultoi se procesi i rivlerësimit do të kryhet nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni), me vendimin e datës 22.1.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 29.1.2019, subjekti i rivlerësimit, u njoftua nëpërmjet postës elektronike, mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, përbërjen e trupit gjykues dhe iu kërkua të shprehej nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

6. Në datën 13.2.2019, subjekti, njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me asnjërin nga anëtarët e trupit gjykues.

7. Trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 15.9.2020, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, vetëm për kriterin e pasurisë.

8. Në datën 19.9.2020, subjekti u njoftua në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit dhe të drejtën për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes, kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave brenda datës 5.10.2020.

9. Në datën 2.10.2020, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike, duke kërkuar kohë shtesë për kthimin e përgjigjeve të rezultateve të hetimit dhe depozitimin e provave, si dhe kërkoi hapjen e hetimit administrativ për të dyja kriteret e tjera të vlerësimit, të kontrollit të figurës dhe aftësitë profesionale.

10. Në datën 5.10.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike për shtyrjen e afatit të kthimit të përgjigjeve nga Komisioni deri në datën 20.10.2020, ndërsa për rihapjen e hetimit për dy kriteret e tjera, Komisioni e çmoi të panevojshme në këtë fazë të hetimit. Ndërkohë që në datën 6.10.2020, subjekti i rivlerësimit u paraqit në Komision, ku tërhoqi të gjitha materialet e hetimit administrativ.

11. Në datën 20.10.2020, subjekti i rivlerësimit dërgoi në Komision shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe kërkoi përsëri rihapjen e hetimit për kriterin e figurës dhe aftësive profesionale.

12. Në datën 4.11.2020, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se është ende në pritje të disa dokumenteve që janë të rëndësishme për barrën e provës dhe kërkon përsëri kohë shtesë.

13. Trupi gjykues, me vendimin e datës 17.11.2020, vendosi rihapjen e hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë dhe në datën 20.11.2020 njoftoi subjektin e rivlerësimit me rrugë elektronike.

14. Në datën 12.1.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike nga Komisioni për rezultatet shtesë të hetimit për kriterin e pasurisë, ku iu dha kohë për kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave deri më 18.1.2021.

15. Në datën 15.1.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se afati deri në datën 18.1.2021 ishte i pamjaftueshëm për të siguruar provat e nevojshme dhe kërkoi shtyrjen e afatit edhe me 15 ditë të tjera.

16. Në datën 15.1.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike nga Komisioni se në lidhje me kërkesat e bëra për të marrë përgjigjet e pritura, ato ndodhen te dosja që Komisioni ka vënë në dispozicion për subjektin, i cili duhet të paraqitet për t'u njohur me to, ndërsa në lidhje me afatin, Komisioni rikujtoi subjektin që është po në datën 18.1.2021.

17. Në datën 18.1.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike duke dërguar shpjegimet për rezultatet shitesë të hetimit, por subjekti shton se pjesën tjetër të prapësimeve do e dërgojë në vijim sapo ta ketë gati.

18. Trupi gjykues, me vendimin e datës 19.1.2021, vendosi ta ftojë subjektin në seancën dëgjimore, e cila do të mbahej në datën 29.1.2021, ora 10:00. Subjekti i rivlerësimit, në datën 21.1.2021, u njoftua nga Komisioni në rrugë elektronike për seancën dëgjimore.

19. Në datën 27.1.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se është në pamundësi për t'u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 29.1.2021 për shkaqe shëndetësore dhe kërkon shtyrjen e saj, duke bashkëngjitur edhe raportin mjekësor për paafësi të përkohshme në punë deri në datën 10.2.2021.

20. Trupi gjykues, me vendimin e datës 28.1.2021, vendosi pranimin e kërkesës së subjektit për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe, po më 28.1.2021, e njoftoi subjektin në rrugë elektronike për pranimin e kërkesës për shtyrje për shkak pamundësie shëndetësore dhe për seancën e radhës do të njoftohej në ditët në vijim.

21. Trupi gjykues, me vendimin e datës 2.2.2021, vendosi të caktojë seancën dëgjimore, e cila do të mbahej më 11.2.2021, ora 10:30, duke e njoftuar subjektin në rrugë elektronike.

22. Në datën 9.2.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike duke i bërë me dije se kërkon pezullimin e seancës dëgjimore të datës 11.2.2021, ora 10:30 deri në shqyrtimin e kërkesës nga KLGj-ja. Subjekti deklaroi se ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) "heqjen dorë në mënyrë të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit" dhe "heqjen dorë në mënyrë të parevokueshme nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë". Subjekti ka bashkëngjitur kërkesën për dorëheqje në mënyrë të parevokueshme nga statusi i magjistratit dhe nga detyra e gjyqtarit të Apelit.

23. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e seancës dëgjimore është protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.2.2021. Gjithashtu, subjekti ka bashkëngjitur edhe kërkesën për dorëheqje të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit, si dhe nga funksioni i gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë me shënimin "dorëzuar në KLGJ, në datën 9.2.2021".

24. Në datën 10.2.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike që Komisioni u njoh me kërkesën e subjektit për pezullimin e seancës dëgjimore dhe i bën me dije se seanca dëgjimore do të zhvillohet pas vendimmarrjes nga KLGj-ja.

Komisioni i bën me dije gjithashtu subjektit se ka të drejtën të shprehet në lidhje me përfundimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke mbajtur në konsideratë pikat 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni i kërkoi subjektin, nëse ai dëshiron, të shfrytëzojë të drejtën për të marrë pjesë në seancën dëgjimore që do të njoftohet në të ardhmen ose nëse dëshiron të heqë dorë nga kjo e drejtë.

25. Në datën 13.2.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se ai nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore.

26. Me shkresën “Njoftim vendimi” të datës 17.2.2021¹, protokolluar nga Komisioni në datën 17.2.2021, KLGj-ja njoftoi miratimin e kërkesës për dorëheqje të subjektit Gramoz Levanaj, duke deklaruar mbarimin e statusit të tij si magjistrat pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe vuri në dispozicion të Komisionit vendimin nr. ***, datë 16.2.2021.

27. Me vendimin nr. ***, datë 16.2.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: (i) deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Gramoz Levanaj, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status; (ii) se efektet e këtij urdhërimi fillojnë datë 31.3.2021; (iii) të përjashtojë gjyqtarin Gramoz Levanaj sipas kërkesave të germës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publikimi në faqen zyrtare të KLGJ-së; (iv) se kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve ,nga data e njoftimit, në Gjykatën e Apelit Administrativ.

28. Komisioni, me shkresën e datës 1.4.2021², ka kërkuar nga KLGj-ja të konfirmojë nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, është bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 16.2.2021, apo nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

29. KLGj-ja, me shkresën e datës 13.4.2021³, ka informuar Komisionin se nga Gjykata Administrative e Apelit është konfirmuar se deri më 7.4.2021 nuk është paraqitur ankim nga subjekti Gramoz Levanaj ndaj vendimit nr. ***, datë 16.2.2021, të KLGj-së⁴.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

30. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit Gramoz Levanaj ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

31. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- ii. Procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk ka përfunduar me vendim, sipas pikës 1 të nentit 58 dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59 “konfirmim në detyrë”, të nenit 60, “pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit” dhe të nenit 61 “shkarkimi nga detyra”.
- iii. Subjekti i rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen duke paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit me vendimin nr. ***, datë 16.2.2021, ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit Gramoz Levanaj, për shkak të dorëheqjes.

32. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2021, e KLGj-së.

² Shkresë nr. *** prot., datë 1.4.2021, e Komisionit.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2021.

⁴ KLGj-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2021, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit ka kërkuar informacion nëse nga subjekti Gramoz Levanaj është ushtruar ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 16.2.2021. KLGj-ja ka bashkëngjitur edhe përgjigjen nr. *** prot., datë 8.4.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit.

33. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

34. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”*.

35. Me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, “nga funksionet e magjistratit” dhe të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e këtij statusi në datën 16.2.2021.

36. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, në datën 10.2.2021, i bëri me dije subjektit të rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, se gëzon të drejtën për t’u dëgjuar nga Komisioni në seancë dëgjimore, e në rast të kundërt procesi i rivlerësimit ndaj tij do të ndërpritej pa seancë dëgjimore, duke i kërkuar të shprehet për sa më sipër.

37. Pas dërgimit të njoftimit në lidhje me respektimin nga Komisioni të së drejtës së tij për t’u dëgjuar, subjekti i rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës, 13.2.2021, shprehu qëndrimin e tij se nuk dëshironte të dëgjohej në seancë dëgjimore.

38. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gramoz Levanaj.
2. Ndalimin e emërimit të z. Gramoz Levanaj si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall, në datën 14.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Anëtare

Olsi KOMICI
Relator

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj